



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA-VLADA-GOVERNMENT	
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE	
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite-Ministry of Labour and Social Welfare	
Sektori i Arkivit-Sektor Archive-Archive Sector	
Organizata Org.	Nr. Proti
Organizata Org.	Broj Proti
Organizata Org.	Privat. No.
Organizata Org.	Data
Organizata Org.	Datum
Organizata Org.	Date
Organizata Org.	12.04.18
Organizata Org.	Prishtine-Prishtina-Prishtina

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

KONTRATA

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe
[RONEX SH.P.K] (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike
për:

me numër Identifikues **209/018/010/-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Shërbimet e Dizajnit ,Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së UEB Faqes së MPMS**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **15.04.2018** dhe përfundon me **15.05.2018**. *Ndërkaq Mirëmbajtja e UEB faqes është e obliguar 36 muaj pas dorzimit të Kodit burmor, dhe përfundimit të tërësishëm të URB faqes.*

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë kalendarik nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **MPMS- përkatësisht Zyra e Informimit Prishtinë**.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **[4,777.00] €; [Katër mijë e shtatëqin e shtatëdhjetë e shtatë] Euro.**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës, pranimit të shërbimeve nga një komision i cili do të emërohet nga MPMS, dhe menaxherit të projektit.

Ndërkaq kompania duhet të përmbahet Deklaratës ku përshkruhen, kushtet dhe procedurat e mirëmbajtjes dhe të sigurojë që të gjitha problemet do të zgjidhen sipas urgjencës së kërkesës nga MPMS, për periudhën 36 mujore.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

1. 6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Si më poshtë
2. Ueb faqja duhet të inkorporojë teknologjinë e fundit për dizajnin dhe zhvillimin e ueb faqes, dizajn atraktiv, dinamik dhe të pastër, konform standardeve të përcaktuara nga W3C;
 - Përmbajtja e faqes duhet të prezantohet nëpërmjet menyve të organizuara në mënyrë tematike, ashtu që t'u përgjigjet nevojave të publikut;
 - Ueb faqja duhet t'i përmbushë kërkesat për transparencë të institucioneve publike të Republikës së Kosovës, duke ofruar mundësi të lehtë të gjetjes dhe navigimit të informacionit; CSS për ndarje të përmbajtjes dhe bazës së të dhënave si dhe mirëmbajtje të lehtë;
 - Ofertuesi duhet të propozojë së paku dy mostra (preview) të dizajnit dhe strukturës së re të ueb faqes së MPMS-së. Dizajni duhet të reflektojë karakterin institucional dhe përfaqësues të Republikës së Kosovës (ngjyra e kaltërt, e bardhë dhe e verdhë);
 - MPMS mban të drejtën për të kërkuar ndryshime apo kombinime të dizajnit dhe mënyrës se si është bërë organizimi i faqes deri sa të arrihet kënaqshmëri me rezultatin dhe plotësohen kushtet e dhëna në këtë specifikacion;
 - Të gjitha materialet në ueb faqe duhen të jenë në shqip, anglisht dhe serbisht dhe kalimi ndërmjet të njëjtës përmbajtje për në gjuhët tjera të bëhet në mënyrë direkte;
 - Faqja duhet të jetë dinamike dhe të përfshijë module që freskohen automatikisht (lajmet, rubrikat, foto dhe video galeritë, dokumentet, etj). Kompania fituese është e lirë të propozojë alternativa më të mira dhe më moderne;
 - Të ndahen hapësira për rubrika të foto galerisë dhe video galerisë, ku albumet ndahen sipas ngjarjeve por edhe sipas datave;

- Të lejohet mundësia për shtypjen e faqes (print), shpërndarjes nëpër rrjete sociale apo me email, si dhe shndërrimit në PDF;
- Dizajnimi i mundësisë për kërkime (search) në çdo kohë dhe të ofrojë mundësi për kërkim të avancuar (advanced search) si dhe sitemap-it;
- Ueb faqja duhet të jetë e përshtatshme me dimensione të ndryshme të ekranëve, gjithashtu duhet të përmbajë edhe versionin mobil, lexim të faqes në telefona celularë, smartphones;
- Integrim i mediave sociale dhe teknologjisë së fundit në ueb faqe.
- Prezantimi, shfaqja tek kategoria raporte-publikime duhet të kenë filtrin e renditjes në faqe (grid 2-3, column);
-

3. Specifikacionet e teknologjisë

- Teknologjia që do të përdoret gjatë dizajnit dhe zhvillimit të aplikacionit duhet të jetë e përkrahur nga platformat të cilat përdoren në institucionet e Republikës së Kosovës.
- Ueb Faqja duhet të zhvillohet konform Udhëzim Administrativ MAP nr. 01-2015 për Ueb faqet e Institucioneve Publike.
- CMS (Content Management System);
- Programimi teknologjik i fundit dhe modern;
- Të përkrah numër të pakufizuar të përdoruesve paralel që informatat të jenë të qasshme nga të gjithë;
- Të ketë sistem autentifikimi të sigurt që i parandalon kycjet e paautorizuara dhe i mbron fjalëkalimet;
- Administrimi i faqes të bëhet përmes protokolit HTTPS / SSL;
- Sistemi i menaxhimit duhet të ofrojë panel menaxhimi për administratorin;
- Të ofrojë mundësinë për të shtuar, ndryshuar dhe për të hequr përmbajtjen (tekstin) e dokumenteve, fotove, etj;
- Të ketë strukturë shumë-shtresore për organizim të pastërt të zhvillimit dhe mundësi më të shpejtë të ndërrimit.

4. Siguria dhe mirëmbajtja

- Fituesi (kompania) duhet të ofrojë backup ditor, kontrollim dhe garantim të sigurisë, dhe mbrojtje të ueb faqes nga sulmet eventuale dhe rreziqet e njohura në internet, dhe të ketë kontroll të plotë të kthejë faqen në gjendjen e mëparshme funksionale;
- Baza e të dhënave duhet të sigurohet ndaj ndërhyrjeve joligjore;
- Mirëmbajtje e faqes për kohëzgjatjen e kontratës;
- Duhet të sigurojë ndihmë teknike brenda ditës dhe sipas nevojës;
- Ofertuesi mban përgjegjësi për migrimin (bartjen) e shënimeve dhe databazës ekzistuese, që janë me kapacitet rreth 40 GB, përfshirë Video dhe foto materiale, në sistemin e ri;
- Në rast të mosfunksionimit të ueb aplikacioneve apo ueb faqes, fituesi është përgjegjës në zgjidhjen e problemit brenda një kohe të shkurtër kohore, respektivisht brenda ditës;
- Në rast të pengesave brenda ueb faqes, ato duhet të identifikohen dhe të zgjidhen nga

zhvilluesi i saj;

5. Ueb aplikacionet e kërkuara

- Duhet të ketë aplikacion për të bërë ndryshime në ueb faqe dhe nën-faqe;
- Duhet të ketë sistem për të shtuar dokumente të ndryshme në ueb faqe (Video, Audio, Fotografi, Dosje/Fajla/Dokumente (psh. Word, Excel, PDF, etj.);
- Të jetë mundësia e kopjimit të fotografisë direkt nga ballina e ueb faqes pa pasur nevojë të klikohet tek lajmi apo galeria;
- Për çdo postim si në lajme, publikime dhe fotografi të jetë opsioni i sortimit dhe kategorizimit si; Të fundit, më të vizituarat, etj.;
- Duhet të ketë aplikacionin për krijim të sliderave në lëvizje me imazhe dhe tekst (*jo me flash player*) dhe mundësia e publikimit në çdo faqe të uebit sipas nevojës;
- Duhet të krijohet një formë kontaktuese e cila do të shërbejë për biseda me palët e jashtme (qytetarët);
- Duhet të ketë aplikacion për menaxhim të linqeve (lidhjeve);
- Duhet të ketë implementime në gjithë ueb faqen e sistemit "Breadcrumbs";
- Duhet të ketë formën kontaktuese digjitale lidhur me qasjen e dokumenteve publike;
- Duhet të ketë aplikacion për lajme/risi i cili duhet të jetë prezent në krye të faqes në çdo kohë; ndër banerin kryesor të shfaqen 5 lajmet kryesore të cilat ndërrohen në mënyrë rotative;
- Të inkorporohen linqet e Inspektoratit të Punës dhe Agjencionit të Punësimit në Ballinë;
- Publikimi i materialeve dhe lajmeve të jetë mundësia e kategorizimit sipas viteve, muajve dhe ditëve;
- Të krijohet rubrike e veçante në faqe, në atë mënyrë që të bëhet një radhitje e duhur e kategorive (ministra, departamentet, legjislacioni, lajmet, agjencionet, etj.).
- Duhet të ketë një hapësirë e veçantë, rubrike për inkorporimin e spoteve të fushatave vetëdijësuese, konferencave të posaçme apo aktiviteteve të veçanta që i mbajmë.
- Ofertuesi do të marrë përgjegjësinë dhe të garantojë që ose është pronar i programeve dhe veprave të tjera autoriale ose kushtet e licencimit apo nën licencimit lejojnë përdorimin e veprës për nevoja komerciale;
- Fituesi i kontratës është i obliguar të ofrojë trajnim për administratorin dhe stafin tjetër të ueb faqes;
- Trajnimet duhet tu mundësojnë administratorëve të kuptojnë se si të përdoret ky sistem menaxhimi, përfshirë këtu se si të shtohen, ndryshohen dhe fshihen të dhënat;
- Rubrika e aktivitetit javor të jetë e përfshirë në faqen e re.
- Ueb faqja duhet të ketë: Hartën e Faqes (strukturën e faqes); Lidhja me portalin shtetëror, me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

6. Dokumentacioni përkatës për trajnim duhet të përmbajë të gjitha detajet rreth ueb faqes si dhe mënyrës së shfrytëzimit;

- Pas kompletimit të ueb faqes, kompania është e obliguar të dorëzojë në të dy formatet, elektronike (*në formë video dhe butonit HELP, ngjashëm me sistemin operativ*) dhe të printuar, këto dokumente;
- Manualin e përdorimit të ueb faqes;
- Manualin e detajeve teknike (*hostimit dhe publikimit*) dhe të administrimit të ueb faqes;
- Materialin e trajnimit të përdorur gjatë trajnimit të stafit;
- Kodet burimore dhe manualin e komentimit të kodit burimor;
- Video manualin e përdorimit dhe administrimit të sistemit sipas roleve;

- Kompania duhet të dorëzojë një dëshmi që do të mirëmbajë ueb faqen 3 vite pas dorëzim-pranimit;
- Çmimi i mirëmbajtjes përfshihet në çmimin e kontratës baze të ofruar nga ana e kompanisë;
- Kompania në marrëveshjen për mirëmbajtjen e ueb faqes, duhet të paraqesë kushtet dhe procedurat e mirëmbajtjes dhe të sigurojë që të gjitha problemet do të zgjidhen sipas urgjencës së kërkesës nga MPMS;
- Kompania duhet të ketë parasysh që MPMS ruan të drejtën që të shtoj kërkesa nëse paraqitet nevoja për ndërrim, shtim etj. të funksionaliteteve gjatë fazës së mirëmbajtjes;

Neni 7 Garancioni

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet*, brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar

me kontratë: b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe*² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	<i>FARUK BERISHA</i>	Emri:	FETI IBISHI
Pozita:	<i>DREJTOR</i>	Pozita:	Kryesues i Divizionit të prokurimit
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	<i>12.04.2018</i>	Data:	<i>12-04-2018</i>
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Çmimi total me TVSH (€)
1.	Shërbimete Dizajnit dhe Zhvillimit të UEB Faqes së MPMS	3,777.00
2.	Mirëmbajtja e UEB faqes për një periudhë 36 mujore	1,000.00
Totali i Përgjithshëm		4,777.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	RONEX SH.P.K
ADRESA E PLOTE	Rr. MBRETI PIRRO P.N., 10000 PRISHTINË
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	FARUK BERISHA
POZITA	DREJTOR
NENSHKRIMI	
DATA	13.03.2018
VULA	

OE
NSH SPIWP AGENCY